

Në vijim të mandatit të vet ligjor sipas Neneve 26.1 dhe 26.2 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë Nr. 2004/09, dhe në mungesë të Kodit përkatës të Matjes, Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, në një sesion të mbajtur më 18 prill 2006, nxjerr si vijon:

## **UDHËZIM I PËRKOHSHËM Nr\_01\_2006**

### **Për Kriteret Matëse ndaj Konsumatorëve të Privilegjuar**

1. Udhëzimi i Përkohshëm do të hyjë në fuqi pas botimit të tij në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së dhe do të mbetet në fuqi deri në aprovimin e Kodit përkatës të Matjes nga ana e Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë.
2. Paketa e dispozitave teknike në lidhje me matjen dhe aparate të tjerë shoqërues që mund të përdoren në pikat komerciale dhe të kontrollit të matjes, është e bashkangjitur me Udhëzimin e Përkohshëm si Shtojca 1.
3. Furnizuesit dhe konsumatorët e privilegjuar janë të detyruar të jenë në pajtim me kriteret e këtij Udhëzimi të Përkohshëm.

Bordi i ZRRE-së

Nick Frydas, Kryesues,

Merita Kostari, anëtare,

Theranda Beqiri, anëtare

Nysret Avdiu, anëtar

Naim Bejtullahu, anëtar

# SHTOJCA I

## PËR UDHËZIMIN Nr\_01\_2006

### 1. HYRJE

Ky Udhëzim ka për qëllim sigurimin e një pakete me kritere të përgjithshëm dhe specifike që do të përmbushë skema matëse e konsumatorëve të kualifikuar për operimin e tyre si pjesëmarrës të tregut të energjisë elektrike. Në këtë kontekst, ky tekst përcakton standardet minimale për matjen dhe regjistrimin e sasive të matura të energjisë elektrike për qëllime të tregtimit dhe transportit të energjisë elektrike në Kosovë.

### 2. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

#### 2.2 Fushëveprimi

Ky Udhëzim Administrativ është i botuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) në mënyrë që të mbulojë kriteret e kyçjes së Konsumatorëve të Kualifikuar të cilat ekzistojnë përpara miratimit të Kodit të Matjes. Për këtë arsye, është e parashikuar që Kodi i Matjes i miratuar do të ndryshojë dhe/ose zëvendësojë këtë Udhëzim Administrativ dhe do të mbisundojë mbi çdo mosmarrëveshje që mund të rrjedhë midis tyre.

#### 2.3 Objektivi

Kjo Rregullore, specifikon kushtet për të gjithë Pajisjet Komerciale Matëse duke përcaktuar në vazhdim:

- (a) Kriteret teknike, projektues dhe operacionale(funksionale);
- (b) saktësinë dhe kalibrimin;
- (c) leximin e njehsorëve.

#### 2.4 Kriteret e Përgjithshëm të Matjes

Kriteret matëse në instalimet e konsumatorëve duhet të plotësojnë standardet më të larta për kufinj të saktësisë së pajisjeve matëse të specifikuar në dokument, dhe gjithashtu duhet edhe të plotësojnë kriteret vijues të specifikuar në dokument;

- Sigurimin e njehsorëve kryesorë dhe kontrollues
- Sigurimin e pajisjeve për ekzaminimin elektronik nga distanca
- Sigurimin e pajisjeve matëse profile
- Sigurimin e pajisjeve për tregtimin e Kohës Sezonale dhe Ditore (STOD).

### **3. KRITERET E PËRGJITHSHME TEKNIKE**

#### **3.1 Hyrje**

Ky seksion përcakton kriteret e përgjithshëm teknikë për Pajisjet Matëse të kërkuar për matjen dhe regjistrimin e transferit të energjisë elektrike në Pikat e përcaktuara Matëse. Dispozitat e kësaj Rregulloreje do të aplikohen njësoj për Njehsorët kryesorë dhe ata kontrollues.

#### **3.2 Referencat**

Në tekst janë referuar Standardet vijuese të cilat do të aplikohen (Normat Evropiane – NE dhe ato të Komisioni Elektroteknik Ndërkombëtar -KEN):

- (a) NE 60687 – Njehsorët Statikë për rrymë alternative Vat-orë njehsorët për Energjinë Aktive (Cl. 0.2S dhe 0.5 S)
- (b) NE 61268 – Njehsorët Statikë për rrymë alternative Var-orë njehsorët për Energjinë Reaktive (Cl. 2 dhe 3)
- (c) NE 60521 – Cl. 0.5, 1.0 dhe 2.0 për Njehsorët për rrymë alternative me Vat-orë.
- (d) NE 60044-1 – Transformatorët e Rrymës (TR)
- (e) NE 60044-2 – Transformatorët e Tensionit (TT)
- (f) NE 60044-3 – Transformatorët Instrument – Transformatorët e Kombinuar
- (g) Standardi i KEN 61036 - Njehsorët Statikë të rrymës alternative Vat-orë për Energjinë Aktive (Cl. 1 dhe 2)
- (h) NE 61107 – Shkëmbim i të Dhënave për leximin e njehsorëve– shkëmbim lokal direkt i të dhënave.

#### **3.3 Pika Matëse**

- 3.3.1 Pika Matëse e përcaktuar do të jetë në pikën kyçëse në Sistemin e Shpërndarjes ose Transmetimit, siç përcaktohet në marrëveshjen përkatëse për kyçjen në sistem.
- 3.3.2 Bazuar në aprovimin e ZRRE-së, Pikat Matëse reale mund të jenë të ndryshme nga Pika Matëse e Përcaktuar. Në këto raste, kriteret e saktësisë së Kodit të Matjes, do të aplikohen në Pikën Matëse të përcaktuar dhe do të aplikohet Seksioni 3.8.5.
- 3.3.2 Pajisjet Matëse do të jenë të afta të përcaktojnë rrjedhjet Aktive dhe Reaktive të Energjisë (siç kërkohet) gjatë çdo Periudhe të Ngarkesës përgjatë çdo Pike Matëse të Përcaktuar.

### **3.4 Njehsorët Kryesorë dhe të Kontrollit**

- 3.4.1 Për kyçje më të mëdha se 10 MVA do të sigurohen Njehsorë Kryesorë dhe të Kontrollit. Këta do të operojnë nga mbështjellës (bobina) të ndara të TR dhe TT.
- 3.4.2 Mbështjellësit e TR dhe të TT dhe kabllot që i lidhin këta mbështjellës në Njehsorët Kryesorë, do të dedikohen për këto qëllime dhe këta kabllot dhe kyçje do të vulosen për të u siguruar..
- 3.4.3 Mbështjellësit e TR dhe të TT dhe kabllot që i lidhin këta mbështjellës në Njehsorët Kontrollues, mund të përdoren për qëllime të tjera në rast se plotësohen të gjithë kriteret e përgjithshme të saktësisë dhe prova e vlerës së ngarkesës shtesë është në dispozicion për inspektim nga Administratori për Rregullimin e Sistemit.
- 3.4.4 ngarkesat e Njehsorit Kryesor, Njehsorit të Kontrollit dhe ngarkesa të tjera shtesë do të kenë siguresa të ndara në TT.

### **3.5 Parametrat e Matjes**

Operatori i Tregut në çdo kohë do të përcaktojë qartë një dokument politikash të aprovuar nga ZRRE-ja, i cili do të specifikojë politikat vijuese, por nuk do të kufizohet vetëm nga to:

- Pragjet për njehsorët të cilët do të matin vetëm në KWh;
- Përdorimin e ndërprerësve Kohorë;
- Përdorimin e kyçjeve të pamatura
- Pragjet për njehsorët e Ngarkesës Maksimale
- Pragjet për Matjen Profilit të ngarkesës

Ndryshimet për këto politika që kërkohen nga Shfrytëzuesit ose Operatorit të Tregut, do të dorëzohen në ZRRE kohë pas kohe për të marrë aprovimin prej saj.

- 3.5.1 Për çdo qark të veçantë, Pajisja Matëse do të jetë e aftë të matë parametrat vijues:

(a) KWh e importit;

Dhe përveç kësaj, për kyçjet me një Ngarkesë Maksimale më të madhe se pragu i specifikuar në dokumentin e politikave të operatorit të tregut.

(b) kVArh e importit

- 3.5.2 për kyçjet me prag të Ngarkesës Maksimale të specifikuar në politikën përkatëse, vlerat vijuese të kërkesës maksimale (KM) do të regjistrohen për çdo periudhë tarifore

(a) KW e importit;

(b) kVAr e importit

Njehsorët do të regjistrojnë KM për 24 orë dhe do të jenë në gjendje të regjistrojnë veçmas 4 vlera shtesë të KM për periudha të programuara kohore.

3.5.3 për kyçjet ku energjia elektrike tregtohet sipas tarifës së kohës sezonale dhe ditore, (STOD) të aprovuar nga ZRRE-ja, njehsorët do të sigurojnë regjistrat vijues;

(a) Tetë regjistra energjetikë të përzgjedhshëm përgjatë vitit kalendarik për kyçje tre fazore.

(b) Katër regjistra energjetikë të përzgjedhshëm përgjatë vitit kalendarik për kyçje një fazore.

3.5.4 Për kyçjet me Ngarkesë Maksimale prej më pak se pragu i specifikuar në dokumentin përkatës të politikave, do të matet vetëm kWh (përveç kur furnizimet janë të pamatura prej marrëveshjes për sa i përket pragut të specifikuar në dokumentin përkatës të politikave). Kur të nevojitet, njehsorët do të jenë të përshtatshëm për multi-tarifa ose tarifa për kohën e shfrytëzimit të kontrolluar nga [një orë integrale].

3.6 Matje gjatë çdo ore

### 3.6.1 Hyrje

Ky seksion përshkruan kriteret teknike për matjen gjatë çdo ore. Këta kritere janë përveç atyre të përshkruar në paragrafin 3.5.

3.6.2 Parametrat Matës

3.6.2.1 Për çdo qark të veçantë, Pajisja Matëse do të jetë në gjendje të masë parametrat vijues:

(a) kWh e importit;

(b) kVArh e importit

Për çdo qark të veçantë, Pajisja Matëse e Gjeneratorëve dhe konsumatorëve me gjenerimin vetjak do të jetë në gjendje të masë veçmas parametrat vijues:

(c) kWh e eksportit

(d) kVArh e eksportit

3.6.2.2 për çdo qark të veçantë, dhe për çdo Periudhë Ngarkesës gjatë një ore, Pajisja Matëse do të jetë në gjendje të regjistrojë Vlerat vijuese të Ngarkesës:

(a) KW e importit;

(b) kVAr e importit

Për çdo qark të veçantë, dhe për çdo Periudhë Ngarkesës gjatë një ore, Pajisja Matëse e Gjeneratorëve dhe konsumatorëve me gjenerimin vetjak do të jetë në gjendje të masë veçmas parametrat vijues:

(c) kW e eksportit

(d) kVAr e eksportit

### **3.7 Standardet e Pajisjeve Matëse**

3.7.1 Njehsori do të mbyllet në një kabinë ose do të instalohet në atë mënyrë që do të jetë në pajtueshmëri me kushtet e deklaruara ambientale të prodhuesit (manifakturuesit). Instalimi do të sigurojë mbrojtje prej lagështirës dhe hyrjes së pluhurit si dhe nga dëmtimet fizike, përfshirë vibracionin. Përveç kësaj, kabina ose njehsori duhet të vulozet që të parandalojë çasjen e paautorizuar.

3.7.2 Në pajtim me NE 60044-1 si dhe me NE 60044-2, do të sigurohen një Transformator i Rrymës (TR), dhe një Transformator Tensioni (TT) për matjen e kërkuar.

3.7.3 Kur sigurohet një transformator i kombinuar matjeje (TT & TR), do të sigurohen 'Testet për Saktësinë' siç përcaktohet në Nenin 8 të Standardit 60044-3 të KEN, për të mbuluar efektet e ndikimit të përbashkët.

3.7.4 Në pajtim me NE 60687, NE 61036 ose NE 60521 njehsorët do të lidhen në TR dhe TT, përveç nëse njehsori është i lidhur direkt, dhe do të vendoset në një ambient të sigurt në afërsi të ndonjë pajisjeje telekomunikimi dhe pajisjeje që shërben për hyrjen në të dhëna.

3.7.5 Të gjithë Njehsorët, do të përfshijnë një Regjistër Njehsori të qëndrueshëm për të regjistruar energjinë e kumulative gjatë çdo sasi të matur. Regjistri(at) i Njehsorit nuk do të rrotullohen më shumë se një herë brenda ciklit normal të leximit të Njehsorit.

3.7.6 Të gjithë njehsorët aktual do të instalohen në përputhje me politikat e operatorit të tregut.

### **3.8 Saktësia e Pajisjeve dhe Kufinj të Gabimeve**

3.8.1 Saktësia e pjesëve të ndryshëm të pajisjes matëse do të jetë në pajtueshmëri me standardet përkatëse të KEN (ose me Standardet Evropiane ekuivalente).

3.8.2 Për qëllim të kësaj Udhëzimi, kapaciteti i qarkut nominal në MVA do të përcaktohet nga pajisja (stabilimenti) parësore me ngarkesë nominale më të ulët (p.sh. ngarkesa nominale e transformatorit, ngarkesa nominale e linjës, etj) të qarkut. Sigurimi e Pajisjes Matëse dhe kriteret e saktësisë, do të paraprijnë çdo ngarkesë shtesë nominale të stabilimentit primar të instaluar. Zgjerimi i

vazhdueshëm deri në ngarkesën maksimale nominale duhet të merret parasysh gjatë vlerësimit..

- 3.8.3 Klasa e saktësisë ose e barasvlershmja, bazohet në fuqinë në MVA të kyçjes dhe do të jetë së paku si vijon, si pasojë e funksionimit brenda kufijve të kombinuar të gabimit që janë përcaktuar në paragrafin 3.8.6 më poshtë:-

Lloji i pajisjes	Klasa e saktësisë e pajisjes			
	Për Kyçje			
	>100 MVA	20–100 MVA	1 – 20 MVA	< 1 MVA
Transformatorët e Rrymës	0.2S	0.2S	0.5S	0.5S
Transformatorët e Tensionit	0.2	0.5	0.5	0.5
Njehsorët	0.2S	0.5S	1.0	2

- 3.8.4 TT, TR dhe Certifikatat e Testimit të Njehsorit do të vihen në dispozicion për inspektim.

- 3.8.5 Nëse Pika Reale e Matjes dhe Pika e Përcaktuar e Matjes nuk përputhen, atëherë nëse është e nevojshme, do të bëhet kompensimi për transformatorin e fuqisë dhe/ose humbjet e linjës në mënyrë që të arrihet saktësi e plotë në Pikën e Përcaktuar të Matjes. Kompensimi mund të aplikohet brenda pajisjes matëse ose jashtë saj nga distanca. Në të dy rastet, duhet të regjistrohen faktorët kompensues dhe justifikimi për ta. Këto regjistrime do të vihen në dispozicion për inspektim.

- 3.8.6 Për të bërë matjen e Energjisë Aktive dhe Reaktive, do të testohen dhe kalibrohen Pajisjet Matëse për të vepruar brenda kufijve të përgjithshëm të gabimit, siç përcaktohet më poshtë, pasi merren parasysh gabimet e TR dhe të TT si dhe rezistenca e mbrojtjes së rrjetit ose qarkut. Pajisja kalibruese do të jetë e njohur sipas një standardi të njohur kombëtar ose ndërkombëtar.

Kushti Rryma e shprehur si përqindje e Rrymës së Matur nominale	Kufinjte e Gabimit me Faktorin e Deklaruar të Fuqisë ENERGJI AKTIVE Faktori i Kufinjte e Gabimit për Kyçjet i Fuqisë	>100MVA 20 – 100 1 – 20 MVA < 1 MVA MVA			
		>100MVA	20 – 100 MVA	1 – 20 MVA	< 1 MVA
120% deri në 10% përfshirëse	1	±0.5%	±1.0%	±2.0%	+/- 3.0%
Poshtë 10% deri 5%	1	±0.7%	±1.5%	±2.5%	+/- 3.5%
Poshtë 5% deri 1%	1	±1.5%	±2.5%	±3.5%	+/- 4.0%
120% to 10% përfshirëse	0.5 lag	±1.0%	±2.0%	±3.0%	+/-3.5%
120% to 10% përfshirëse	0.8 lead	±1.0%	±2.0%	±3.0%	+/-3.5%

Kushti	Kufinjtë e Gabimit me Faktorin e Deklaruar të Fuqisë (energjisë) ENERGJI REAKTIVE					
	Rryma e shprehur si përqindje e Rrymës së Matur nominale	Faktori i Fuqisë	> 100MVA	20 – 100 MVA	1 – 20 MVA	<1 MVA
120% to 10% përfshirëse	0	±4.0%	±4.0%	±4.0%	±4.0%	+/- 4.0%
120% to 20% përfshirëse	0.866 lag	±5.0%	±5.0%	±5.0%	±5.0%	+/- 5.0%
120% to 20% përfshirëse	0.866 lead	±5.0%	±5.0%	±5.0%	±5.0%	+/- 5.0%

3.8.7 Regjistrat do të përbëhen nga të dhëna përkatëse që nevojiten për një testim dhe kalibrim të suksesshëm sipas kriterëve të Seksionit 3.8.6 më sipër.

3.8.8 Nëse transformatorët ekzistues të matjes nuk janë në pajtim me gjithë kushtet e këtij Kodi, atëherë ato do të jenë të pranueshëm nëse plotësohen secili nga kushtet vijues:

- (a) Transformatorët e rinj të matjes instalohen (në përputhje të plotë me këtë Udhëzim dhe më pas me Kodin e Matjes) nëse do të kryhet një alterim i madh i stabilimentit elektrik;
- (b) Nëse transformatorët nuk janë plotësisht të dedikuar për rregullimin e Matjes, atëherë ngarkesat shtesë duhet të përcaktohen në sasi dhe duhet të merren parasysh gjatë kalibrimit dhe testimit.

Ngarkesa nuk do të ndryshohet pa njoftim të operatorit përkatës të tregut. Njehsori kryesor, Njehsori i kontrollit dhe ngarkesat e tjera shtesë, do të kenë siguresë të veçantë të TT.

### 3.9 Ruajtja e të dhënave

3.9.1 Pajisjet për ruajtjen e të dhënave të njehsimit, do të sigurohen si vijon:



- (a) një kapacitet ruajtës prej 96 periodave në ditë, me një minimum prej [30] ditësh për të gjithë Vlerat e Ngarkesës;
- (b) Vlerat e ruajtura të Ngarkesës do të jenë vlera të plota matematikore të kW ose kVAr, ose numërime pulsi, dhe do të kenë një rezolucion më të mirë se  $\sim 0.1\%$  (me ngarkesë të plotë)
- (c) saktësia e vlerave të energjisë të përfuara nga Vlerat e Ngarkesës do të jenë brenda  $+ 0.1\%$  (me ngarkesë të plotë) të sasisë së energjisë së matur nga Njehsori i përkatës;
- (d) vlera e energjisë së matur në një Periudhë Ngarkese por që nuk është ruajtur në Periudhën e Ngarkesës, do të përçohet përpara në Periudhën tjetër të Ngarkesës;
- (e) në rast se furnizimi me energji i Pajisjes Matëse dështon, Pajisja Matëse do të mbrojë të gjithë të dhënat e ruajtura deri në kohën e dështimit, dhe do të mbajë saktësinë e kohës në përputhje me paragrafin 3.11 më poshtë;
- (f) për t'u kujdesur për dështimet e vazhdueshme të furnizimit, ora, kalendari dhe të gjitha të dhënat duhet të mbështeten për një periudhë 10 ditore pa kyçe të furnizimit të jashtëm;
- (g) çdo veprim "leximi" nuk do të fshijë ose ndryshojë të dhënat e matura që janë ruajtur;
- (h) Pajisja Matëse do të sigurojë çdo pjesë të të dhënave të ruajtura sipas kërkesës së Sistemit të Mbledhjes së të Dhënave;
- (i) Ruajtja e të dhënave do të bëhet nga brenda ose jashtë Njehsorit përmes një konzentratortë të dhënave;
- (j) Njehsorët që sigurojnë të dhënat për konzentror e të dhënave që gjenden jashtë Njehsorit, do të sigurojnë një informacion për sasinë e matur.

### **3.10 Komunikimet e të dhënave**

- 3.10.1 Matja e profilit të ngarkesës do të pajiset me porta (pika hyrëse) komunikimi standarde për transferimin lokal dhe nga distanca të të dhënave profile të ngarkesës dhe të dhëna të tjera të njehsorit.
- 3.10.2 Të gjithë pajisjet e komunikimit të të dhënave do të jenë në pajtueshmëri me standardet dhe rekomandimet përkatëse të Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU) për transmetimin e të dhënave në sistemet e telekomunikacionit.
- 3.10.3 Kriteret specifike të sigurisë së vendndodhjes mund të aplikohen edhe në përputhshmëri me praktikën e mirë të vendosur dhe në marrëveshje me kriteret specifike të Operatorit të Sistemit.

- 3.10.4 Sistemet e mbledhjes së të dhënave të njehsorëve do ta ekzaminojnë Pajisjen Matëse nga distanca për të nxjerrë të dhënat në intervalet e duhura, siç përcaktohet nga Operatori Përkatës i Tregut.
- 3.10.5 Ekzaminimi nga distanca do të bëhet përmes telefonit me linjë fikse, linjës së dhënë me qira, linjat kryesore të bartura, packet switching data networks ose ndonjë sistem tjetër i përshtatshëm, duke përdorur protokollet e Njehsimit dhe pajisjeve të telekomunikacionit siç specifikohet në standardin 60870 -5 101 të KEN.
- 3.10.6 Në rast se pajisjet e telekomunikacionit dështojnë, të dhënat e Njehsorit do të lexohen nga një Aparaturë e Ngjitur në Vend dhe do të transferohen në sistemin qendror të mbledhjes së të dhënave, siç përcaktohet nga operatori i tregut.
- 3.10.7 Për Njehsorët e rinj dhe ata zëvendësues, të dhënat vijuese do të jenë në gjendje të bëjnë ekzaminimin vijues:
- (a) Vlerat e Ngarkesës
  - (b) Ngarkesa Maksimale dhe Regjistrat e Energjisë

### **3.11 Sinkronizimi**

- 3.11.1 Pajisja Matëse do të rregullohet me Kohën Universale të Koordinuar (UTC) me mundësinë për t'u ndërruar çdo vit në Kohën e Zgjatur (sipas solsticit veror) (DST). Ndërrimi nuk do të bëhet për të dhëna që vijnë gjatë çdo çerek ore.
- 3.11.2 Rregullimet e kohës mund të kryhen siç kërkohet nga komunikimet me Sistemin e Mbledhjes së të Dhënave.
- 3.11.3 Fillimi i çdo Periudhe të Kërkesës do të jetë brenda  $\pm 20$  sekondash nga koha reale. Kohëzgjatja e çdo Periudhe Kërkese do të jetë e saktë deri brenda  $\pm 0.1\%$ , përveç nëse sinkronizimi i kohës është bërë në atë periudhë.